


E DREJTA E FJALËS



ARMA MË E FUQISHME

HISTORIA E DEMOKRACISË

ZARIFE (15), ALMA (14), FATJETA (14), ERBLIN (15), ELION (15), FESTINA (14), EDUART (14),

BLEND (15)



Përshëndetje të dashur lexues. Ne jemi një grup nxënësish të cilët kemi nderin të shkruajmë për historinë e demokracisë. Ju ftojmë ta shikoni dhe ta lexoni punën tonë

Grupi ynë sot ka marrë pjesë në Punëtorinë e Demokracisë „Demos-ti“. Këtu ne kemi diskutuar dhe mësuar më shumë për demokracinë. Gjithashtu, ne mësuar për procesin zgjedhor. Pasi që kishim shumë gjëra që diskutuam bashkarisht, ne vendosëm të ndaheshim në dy grupe të vogla. Prandaj, në këtë artikull jemi Zarifja, Alma dhe Erblini shkrimtarët të cilët do të flasim për demokracinë. Ndërsa, në faqen tjetër ju ftojmë të lexoni artikullin e shkruar nga Eduarti, Fatjeta dhe Festina për procesin zgjedhor. Kurse, Elioni dhe Blendi kanë punuar vizatimet për të dy grupet.

Fjala demokraci rrjedh nga gjuha greke. Dy fjalët greke nga të cilat ka rrjedhur kjo fjalë janë: „demos“ dhe „kratos“. Fjala „demos“ do të thotë popull, kurse fjala „kratos“ do të thotë udhëheqje. Katër elemente më kryesore të cilat përshkruajnë demokracinë, sipas mendimit tonë janë: liria, respekti, barazia dhe të drejtat e barabarta të njeriut. Këto elemente nuk ishin gjithmonë pjesë e demokracisë, sepse në Athinë, në kohën kur është paraqitur për herë të parë kjo formë e qeverisjes, nuk kishin të drejtë pjesëmarrje gratë, të varfërit, fëmijët, skllevërit dhe të moshuarit. Kjo kohë ishte viti 507 para erës sonë. Ndërsa sot, gjithçka ka

ndryshuar. Në demokracinë përfaqësues një rol tejet të rëndësishëm e luajnë votat e qytetarëve. Quhet demokraci përfaqësuese, për shkak se përmes votës ne zgjedhim përfaqësuesit tanë.

Demokracia për ne ka një domethënie të madhe, sepse edhe në shkollën tonë kemi demokraci dhe zbatim të elementeve të saj. Të gjithë ne jemi të lirë, jemi të barabartë dhe kemi të drejtat tona. Ne jemi të lirë të flasim dhe të shprehim mendimet tona lirshëm. E kur neve nuk na pëlqen diçka e caktuar, mund të debatojmë në mes nxënësve dhe arsimtarëve për të bërë procesin mësimor më të suksesshëm. Për shembull, në gjysmëvjetorin e parë ne patëm një debat për dhunën psikologjike dhe nga ky debat kemi arritur që të mendojmë më thellësisht për këtë fenomen dhe të përpiqemi ta largojmë atë nga jeta jonë. E tërë kjo është realizuar përmes shprehjes së lirë të mendimit.



Shkrimtarët e këtij artikulli

ZGJEDHJET E POPULLIT

A keni tentuar ndonjëherë të mësoni për zgjedhjet? Por, nuk keni kuptuar shumë për to? Ndoshta sepse zgjedhjet janë shpjeguar më parë nga të rriturit e asnjëherë nga fëmijët? Për këtë arsye, ne fëmijët sot kemi vendosur të shkruajmë për zgjedhjet,

Të nderuar lexues, sot do të flasim për zgjedhjet në Kosovë. Ne mendojmë se ky proces është shumë i vlefshëm për çdo qytetar, pasi që i ofrohet mundësia secilit që të zgjedh për veten dhe për komunitetin e vet. Kjo zgjedhje nuk ndikon vetëm në veten dhe jetën tonë, por është shumë e rëndësishme edhe për familjet tona, lagjen, fshatin, qytetin, shkollën ku mësojmë dhe shtetin ku jetojmë.

Zgjedhjet në Kosovë ndahen në dy lloje. Ato janë: zgjedhjet komunale (lokale) dhe zgjedhjet parlamentare (qendrore).

Në zgjedhjet komunale votohet vetëm për kryetarin dhe asamblistët e asaj komune. Këto zgjedhje organizohen me rregull një herë në katër vjet.

Në këto zgjedhje kanë të drejtë të votojnë vetëm qytetarët e asaj komune, duke përfshirë edhe fshatrat e komunës. Kurse, në zgjedhjet parlamentare ose qendrore votohen deputetët nga populli me një shumë të caktu-

ar. Ne zgjedhim 120 deputetë në total. Këta deputetë punojnë në Kuvend. Pasi që ata votohen nga ne, detyra e tyre është të zgjedhin Qeverinë e shtetit tonë, më saktësisht Kryeministrin dhe ministrat. Gjithashtu, ata zgjedhin Presidentin, si dhe Kryetarin e Kuvendit.

Të drejtën për të votuar e kanë të gjithë qytetarët prej moshës 18 vjeçare. Mirëpo, kjo nuk do të thotë se fëmijët nuk mund të zgjedhin për veten e tyre.

Fëmijët zgjedhin lojërat të cilat i pëlqejnë. Fëmijët zgjedhin në cilën shkollë do të shkojnë. Ata gjithashtu zgjedhin profesionin e ardhshëm të cilin dëshirojnë ta ushtrojnë kur të rriten.

Ne si nxënës të klasës së IX-të kemi edhe pak muaj mësim në shkollën tonë fillore ku vijojmë mësimet tani. Në muajin qershor, ne do të duhet të bëjmë një zgjedhje shumë të rëndësishme. Ne duhet të zgjedhim në cilën shkollë të mesme dhe në cilin drejtim dëshirojmë të vazhdojmë shkollimin.

Zgjedhja jonë, sipas bisedës të cilën e bëmë në grupin tonë, do të bazohet në lëndët e preferuara tonat, në notat tona, në arritjet e deritanishme, në dëshirat tona, dhe në vullnetin për të arritur sa më lart.


Faleminderit për vëmendjen tuaj! Jeni më të mirët. Mos harroni t'iu tregoni edhe të tjerëve për zgjedhjet.



Buzëqeshjet në fytyrat tona tregojnë shumë



E drejta e votës, e drejta më e rëndësishme në demokraci





Zgjidhja e problemeve na fakon vetëm neve



Ne shkruajmë për zgjedhjet, ju dilni dhe votoni

VLERA E QYTETARISË AKTIVE

GRESA (14), FESTIM (15), BESIANA (15), ELSA (14), ARBRORA (13), SHKËLQIM (14), HASAN (14),
PETRIT (14)



Në demokraci liria e shprehjes së mendimeve dhe marrja e iniciativave është më e lehtë se në çdo lloj sistemi tjetër të udhëheqjes që ekziston

Fjala e popullit luan rol vendimtar në demokraci. Pa dëshirën, vullnetin, përkushtimin dhe pjesëmarrjen e tij, funksionimi i demokracisë në vend nuk do të ishte në nivelin e duhur. Demokracinë e mirëfilltë e realizojnë kush tjetër përpos qytetarëve aktiv, të cilët ndër të

tyre dhe të tjerëve, si dhe zbatojnë me përpikëri ligjet. Për dallim nga qytetarët aktiv janë edhe qytetarët pasiv ose qytetarët me mungesë të vullnetit. Këta individë, që janë në numër më të vogël, nuk marrin dhe nuk ndejnë përgjegjësi për vendin e tyre. Me një fjalë, mendimi i tyre është se roli që ata mund të kenë në shoqëri, nuk është dominant në të mirën e tyre dhe të vendit. Duke u nisur nga kjo, ne kemi zgjedhur të jemi aktiv, sepse mendojmë se kemi përmbushur kushtet për t'u cilësuar të tillë. Për ta dëshmuar këtë, po përmendim aktivitetet që ne i kemi bërë ndër vite. Ne kemi marrë iniciativa pro mbrojtjes së ambientit, vazhdojmë të marrim pjesë në organizata jo qeveritare, ofrojmë ndihmë ndaj personave të tjerë, kemi marrë dhe shpërndarë informata për t'i vetëdijësuar të tjerët, etj. Po ashtu, mund të përmendim rastin e zgjedhjes së kryetarit të klasës me anë të votave, sepse ne dijmë vlerën e votës dhe rëndësinë e zgjedhjes së lirë.



Ne çdo herë propozojmë ide të reja për komunitetin tonë

tjërash mundohen që të sigurojnë mirëqenie sociale për të gjithë. Qytetaria aktive karakterizohet me vullnetin dhe entuziazmin për të bërë ndryshme pozitive në vend. Qytetarët aktiv janë ata të cilët marrin pjesë në tubime publike, marrin dhe japin informacione të sakta, organizojnë dhe marrin pjesë në organizata jo qeveritare, si dhe themelojnë grupe vullnetare punuese. Ata votojnë, ndihmojnë dhe respektojnë të drejtat e



Të dashur dhe shumë aktiv

KUVENDI TË PËRFAQËSON EDHE TY

MIMOZA (15), XHEVAHIRE (14), ELVIS (14), SHQIPONJE (14), BLEONA (15), ERBLINA (14),
ARBнора (14), ALIJONA (14)



Grupi ynë ka diskutuar për Kuvendin e Kosovës. Ishte e pamundur të flasim për këtë institucion dhe për personat që punojnë në të, pa kaluar pak edhe në mënyrën e zgjedhjes së Kuvendit dhe të mirat që vijnë pas zgjedhjes së tij. Siç po e shihni edhe vetë, ne kemi paraqitur votën si element që populli e përdor për të zgjedhur deputetët, rëndësia e së cilës është e madhe. Kurse, në anën tjetër kemi paraqitur një grua dhe një burrë, sepse dëshirojmë të tregojmë që në Kuvend ka barazi gjinore.



Nëse keni dëshirë dhe vullnet të mësoni më shumë për punën që Kuvendi i Kosovës e bën, si dhe për rëndësinë e tij në secilën sferë të jetës sonë, ju ftojmë që të lexoni artikullin në vijim

Kuvendi ka rëndësi të madhe në jetën e secilit qytetar që jeton në Kosovë. Kjo sepse ky institucion është i vetmi që zgjedhet direkt nga populli. Për këtë edhe njihet si institucioni më demokratik në vendin tonë. Pasi që zgjedhet nga populli, përgjegjësitë e tij ndaj këtij të fundit janë të shumta. Si për shembull, një ndër funksionet kryesore të Kuvendit është përfaqësimi i popullit. Çdo ligj që propozohet apo miratohet nga Kuvendi, si pikë synimi ka mirëqenien tonë. Dhe kjo në secilën sferë, si; arsim, shëndetësi, kulturë, etj.

Funksion tjetër i Kuvendit është ai legjislativ. Kuvendi po ashtu, është i vetmi institucion që ka të drejtën e miratimit (apo mos miratimit) të ligjeve. Disa nga këto ligje i cekëm edhe në paragrafin e paraprak. Si ligji për kujdes shëndetësor, ku të gjithë qytetarët pa dallime kanë të drejtë të mjekohen në secilën shtëpi të shëndetit. Kjo është një ndër të drejtat të pamohueshme të secilit qytetar. Përpos kësaj sfere, e kemi edhe fushën e edukimit, ku ne si nxënës jemi të obliguar me ligj të përfundojmë shkollën fillore.

Përveç këtyre dy funksioneve që i thamë, Kuvendi ka edhe funksion kontrollues. Këtë e ushtron ndaj Qeverisë. Arsyeja pse e gëzon këtë të drejtë është sepse Qeveria votohet nga Kuvendi, ashtu siç votohen deputetët nga populli. Dallimi mes tyre është se për ta votuar Qeverinë duhen votuar pro më shumë se 61 deputetë nga 120 sa janë në tërësi. Kurse, për deputetët votojnë afro 1.8 milion banorë. Këto vota janë të ndara në kandidat të ndryshëm. Secili qytetar e voton atë kandidat për të cilin mendon se është më i miri për këtë detyrë.

Nga tërë kjo që e thamë e kuptuam që Kuvendi është shumë i rëndësishëm për ne. Kur edukatorja na pyeti cili funksion mendoni që është më i rëndësishëm, shoqja Xhevahire tha që funksioni i miratimit të ligjeve është më i rëndësishmi. Kurse, Alijona tha që më i rëndësishëm është funksioni përfaqësues. Por, në fund erdhëm në përfundim që të tri këto funksione nuk mund t'i ndajmë nga njëra-tjetra, sepse që të trija kanë rol dhe rëndësi të madhe. A mendoni edhe ju kështu?



Kuvendi na përfaqëson edhe neve



IMPRESUM



Ky publikim është produkt i punës së pjesëmarrësve të projektit „Demos-ti“ i cili realizohet nga



REPUBLIKA E KOSOVËS / KUVENDI
REPUBLIKA KOSOVA / SKUPŠTINA
REPUBLIC OF KOSOVO / ASSEMBLY

i implementuar nga



Projekti është mundësuar dhe përkrahur nga



ERSTE Stiftung

Redaktohet nga
Kuvendi i Kosovës

Qëllimi i publikimit
Edukimi qytetar nëpërmes metodave edukative joformale

shtypur nga
TOKA

Na kontaktoni për të marrë pjesë: Pjesëmarrësit:
Tel: +381 38 704 560 SHFMU „Ibrahim Mazreku“
E-mail: info@demos-ti.org Klasa: IX-3
Website: www.demos-ti.org Vendi: Malishevë